

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJESI TË
KUFIZUAR “DAPHNE” SH.P.K**

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Sot me date 31.03.2021 në bazë të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, me vullnet të lirë Themelues i Shoqërisë “DAPHNE” sh.p.k:

- Erli Doci, i biri I Prenge-s, i datëlindjes 03.12.1983, lindur në Berat, dhe banues në Tirane, Shqiperi pajisur me dokumentin e identitetit, kombetar karte id me Nr. personal I31203054J, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ne cilësinë e ortakut te vetem te shoqërisë “DAPHNE” sh.p.k.

si themeluese e kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, vendosi të hartojë këtë Akt Themelimi, mbështetur në parimet e mëposhtme:

**NENI 2
EMRI**

Emri i shoqërisë është “DAPHNE” shpk.

**NENI 3
FORMA**

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe ortaku do të përballojë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nëshkruara për kapitalin.

**NENI 4
SELIA**

Shoqëria e ka seline e saj në adresen: Rruga “Mikel Maruli”, Pallati Eja, shk. 4, Ap 30 Tirane.

Selia e shoqërisë mund të ndryshohet nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 5
KOHEZGJATJA**

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pa caktuar.

**NENI 6
OBJEKTI**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtroje në baze të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

Import-eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë, tregtim me shumicë dhe me pakicë edhe on-line, shpërndarjen me dhe/ose pa magazine, si kombëtare dhe nderkombëtare, edhe me marrjen e mandateve të përfaqësimit me dhe/ose pa magazine, të artikujve dhe produkteve të ndryshëm spitalor jo medikamente. Tregëti, import – eksport me shumicë dhe pakicë të makinerive e pajisjeve të ndryshme mjekësore, elektro mjekësore, laboratorike, dezinfektuese, si dhe çdo aksesori të mudshëm spitalor për përdorim mjekësor. Riparim dhe mirëmbajtje të pajisjeve dhe aksesoreve spitalore.

Import-eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë, tregtim me shumicë dhe me pakicë edhe on-line, shpërndarjen me dhe/ose pa magazine, si kombëtare dhe nderkombëtare, edhe me marrjen e mandateve të përfaqësimit me dhe/ose pa magazine të makinerive, aparaturave, aparatura estetiko-mjekësore, aksesoreve dhe/ose pajisjeve të ndryshme në fushën e estetikës, dermatologjisë, kozmetikës, parukerisë, fizioterapisë, masazherisë, të integritoreve ushqimore, suplementeve të bimeve medicinale dhe jomedicinale si dhe çdo lloj integritori tjetër.

Import-eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë, tregtim me shumicë dhe me pakicë edhe on-line, shpërndarjen me dhe/ose pa magazine, si kombëtare dhe nderkombëtare, të artikujve elektrike, elektronike, industriale, bujqësore, ndërtim e linja prodhimi, pajisje, aparatura, makineri, impiante aktive dhe jo aktive, materiale dhe artikuj për përdorime të ndryshme (kerkimor-shkencor, mesimor, testuesdiagnostikues publik, komunal, industrial, shtëpiak, etj).

Hapje depo farmaceutike, farmaci, klinika mjekësore, laboratore analizash, spitale, depo veterinare, depo bujqësore ..etj.

NENI 7 KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqinda mijë) lekë i ndarë në një pjesë.

Kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë janë të ndara dhe nënshkruar si më poshtë:

- 1. Z. Ertir Doci** në cilësinë e ortakut themelues zotëron 100% të kapitalit themeltar ose 1 kuotë të barabartë me vlerë prej 100,000 (njëqinda mijë) lekë në kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar i shoqërisë do të shlyhet teresisht brenda 2 (dy) muajsh nga themelimi i shoqërisë dhe do të depozitohet në një llogari bankare të hapur në emer të Shoqërisë në një nga bankat e nivelit të dytë.

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve, por asnjëherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor.

NENI 8
ORGANET E SHOQËRISË

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e përgjithshme;
- Administratori.

Shoqëria mund të emerojë me shume se një administrator. Veprimet e të cileve do jënë njelloj të vlefshme sikur meren bashkarisht ashtu edhe kur meren vec e vec. Në çdo rast, kur termi 'Administrator' përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërisë 'DAPHNE' sh.p.k. ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj, sado qofshin këta në numër.

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese do të rregullohet sipas ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe Statutin e shoqërisë.

NENI 9
ORGANI ADMINISTRATIV

Administrator i parë i shoqërisë për një periudhë 5 (pese) vjetare është emëruar **Z. Erlir Doci**, pajisur me leternjoftimin me nr. personal I31203054J.

NENI 10
DISPOZITAT E FUNDIT

Ky akt themelimi është hartuar në 2 (dy) kopje të njëjta në gjuhën shqipe duke patur secila kopje fuqi të njëjta ligjore.

THEMELUES
Erlir Doci


